



Nr. 01-052/01-147
Datë 05.01.2026

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, me datë **05.01.2026**, harton këtë:

RAPORT VJETOR 2025 PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Në vitin 2025 Komuna e Gjakovës kishte dymijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë (2285) pozita të autorizuar për Zyrtarët Publik (duke përfshirë edhe funksionarët publik). Në këtë numër përfshihen **nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësit e shërbimit publik (arsimi, shëndetësia, kultura, arti etj.), krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës, nëpunësit teknik dhe mbështetës dhe zyrtarët e kabinetit.**

Plani i Personelit 2025 parashikonte njëqind e nëntëmbëdhjetë (119) pozita të lira për pranim dhe transferim nga të gjitha kategoritë e Zyrtarëve Publik. Prej tyre nëntë (9) transferime dhe njëqind e dhjetë (110) pozita për pranim.

Realizimi i Planit të Personelit 2025 është përmbushur përmes njëzet e gjashtë (26) konkurseve publike. Prej tyre gjashtëmbëdhjetë (16) konkurse për pranim në shërbimin civil, dhjetë (10) konkurse për pranim në shërbimin publik, zero (0) konkurse për pranim në kategorinë e performuesve të artit dhe kulturës si dhe zero (0) konkurse për pranim në nivelin teknik dhe mbështetës. Nga të gjitha këto konkurse kanë rezultuar njëqind e shtatëdhjetë e pesë (175) kandidat të suksesshëm.

Gjatë vitit 2025 nuk kemi **asnjë** konkurs të anuluar me vendim/akt gjykim të plotfuqishëm nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni i Ankesave dhe Gjykata kompetente.

• Pranimi në shërbimin civil

Nr.	Grupi	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Drejtor i Qendrës për Punë Sociale	RN00016298	1
2.	Inspektor i Shërbimeve Publike	RN00016315	1
3.	Zyrtar për Përkthime	RN00016319	0
4.	Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë	RN00016355	1
5.	Auditor i Brendshëm	RN00016581	1
6.	Zyrtar për Arkiv	RN00016633	0

7.	Zyrtar për Komunitete	RN00016818	1
8.	Zyrtar i Lartë për Cilësi në Arsim	RN00017116	2
9.	Zyrtar Administrativ	RN00017117	1
10.	Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian	RN00017702	1
11.	Zyrtar për Shërbime Sociale	RN00018164	1
12.	Zyrtar Administrativ	RN00018166	1
13.	Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale	RN00018983	1
14.	Zyrtar për Arkiv	RN00018984	1
15.	Zyrtar për Promovimin e Turizmit	RN00018985	1
16.	Zyrtar për Menaxhimin e Pronës Komunale	RN00018990	1

• **Pranimi në shërbimin publik**

Nr.	Pozita/Grupi	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë	01-111/01-1946	4
2.	Grupi i Arsimit (zëvendësime)	01-111/01-13572	22
3.	Asistent për Arkë	01-112/01-16116	3
4.	Asistent për Telefoni	01-111/01-16727	2
5.	Asistent Administrativ	01-111/01-16865	2
6.	Grupi i Arsimit	01-111/01-21645	96
7.	Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë	01-111/01-24868	19
8.	Grupi i Arsimit (zëvendësime)	01-111/01-42749	3
9.	Asistent për Arkë	01-111/01-44386	3
10.	Grupi i Arsimit (zëvendësime)	01-111/01-47297	6

• **Pranimi te krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës**

Nr.	Pozita/Grupi	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	/	/	/

• **Pranimi në nivelin teknik dhe mbështetës**

Nr.	Pozita/Grupi	Konkursi	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	/	/	/

• **Rregulloja për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e datës 27.03.2025 ka miratuar Rregulloren numër 01-011/01-16155 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës. Kjo rregullore është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe ueb faqen e Komunës së Gjakovës me datë 24.04.2025 dhe hyri në fuqi nga data 02.05.2025.

- **Përshkrimi i vendeve të punës në shërbimin civil**

Pas miratimit të Rregullores numër 01-011/01-16155 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, Grupi i Vlerësimit në koordinim me mbikëqyrësit e drejtpërdrejt ka hartuar draft formularët e përshkrimit të vendeve të punës në shërbimin civil për kategorinë e specialistëve dhe kategorinë profesionale. Ndërsa përshkrimi i punës për nivelin e ulët drejtues është vendosur në formular sipas përshkrimit të detyrave të njësive/sectorëve përkatës në rregulloren për organizimin e brendshëm. Pas **miratimit** të të gjitha përshkrimeve nga Kryetari i Komunës, në përputhje me nenin 21 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) numër 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Grupi i Vlerësimit përmes shkresës numër 01-112/01-31143 i ka proceduar tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të gjitha përshkrimet (nga numri rendor NJMBNJ-FPP/001/2025 deri në numrin rendor NJMBNJ-FPP/148/2025).

- **Transferimi i nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2025 (ristrukturimi)**

Pas miratimit të Rregullores numër 01-011/01-16155 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të ristrukturimit ka krijuar një komision ristrukturimi, i cili ka shqyrtuar mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi në vendet e lira ekzistuese dhe ka propozuar transferimin e nëpunësve në pozitat e lira, për të cilat këta të fundit i plotësojnë kërkesat e vendit përkatës të punës. Komisioni i Ristrukturimit në Komunën e Gjakovës është krijuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes vendimit numër 01-112/02-24137 të datës 13.05.2025 dhe në të njëjtën ditë vendimi për krijimin e komisionit është dërguar tek nëpunësit e Komunës së Gjakovës.

Komisioni, brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e themelimit, i ka propozuar me shkrim njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore, **transferimin e njëqind e nëntëmbëdhjetë (119) nëpunësve**. Komisioni në propozimin e tij numër 01-112/02-32560 për transferimin e nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit është mbështetur në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve.

Numri i nëpunësve të transferuar	Transferimi i përkohshëm	Transferimi si pasojë e ristrukturimit	Transferimi i përhershëm	Transferimi për arsye tjera (të listohen arsyet)
2025	1	119	9	0

- **Numri i nëpunësve të kategorisë drejtuese në shërbimin civil me akt emërim / ushtrues detyre gjatë vitit 2025**

		Kategoria e ulët drejtues
Akt emërim	Gra	14
	Burra	29
Ushtrues detyre	Gra	0
	Burra	0

- **Trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Gjatë vitit 2025 vëmendje iu është kushtuar edhe **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe nëpunësit e rinj.

Kategoria funksionale	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria i specialistëve	Kategoria Profesionale
Numri i stafit të trajnuar	21	5	94
Numri i trajnimeve në të cilat kanë marrë pjesë stafi	12	2	16

- **Masat disiplinore dhe ankesat e zyrtarëve publik në vitin 2025**

Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik, Krijuesit dhe Performuesit e Artit dhe Kulturës dhe Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2025 ka pranuar gjithsej dyzet (40) ankesa prej të cilave tridhjetetë (38) i ka refuzuar, një (1) e ka aprovuar dhe një (1) lëndë është në procedurë.

Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2025 nuk ka pranuar asnjë kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik, Krijuesit dhe Performuesit e Artit dhe Kulturës dhe Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2025 ka zhvilluar gjithsej pesëmbëdhjetë (15) procedura disiplinore prej të cilave në katër (4) procedura ka shqiptuar masën disiplinore - ndërprerje e marrëdhënies së punës, në tri (3) procedura ka shqiptuar masën disiplinore - ndalesë 20% të pagës për dy (2) muaj, një (1) procedurë ka përfunduar më kërkesë të iniciuesit, në një (1) procedurë është shqiptuar masa disiplinore - ndalesë 50% e pagës për tre (3) muaj, në një (1) procedurë është shqiptuar masa disiplinore - pezullim i marrëdhënies së punës, në një (1) procedurë nëpunësi është rikthyer në vendin e punës, dy (2) kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore janë refuzuar si të pa bazuara dhe dy lëndë janë në procedurë.

Periudha		2025
Masa për shkelje të lehta disiplinore		6
Masat për shkelje të rënda disiplinore	Ndalimi nga 20% deri në 50% e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.	4
	Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite.	0
	Transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë.	0
	Ulja në pozitë	0
	Pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj.	0

Pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit.	2
Largimi nga puna.	4

• **Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Vlerësimi i rezultateve në punë të vitit 2025 për nëpunësit e shërbimit civil është duke u realizuar në formatin elektronik përmes sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore, dhe i njëjti përmbyllet me 28.02.2026. Ndërsa për nëpunësit e shërbimit publik (*arsimi, shëndetësia, kultura, arti etj.*), krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës si dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës vlerësimi është duke u realizuar përmes formatit fizik. Për nëpunësit e arsimit parauniversitar vlerësimi do të bëhet për vitin shkollor përkatës. Duke marr parasysh se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2025 është në proces, më poshtë gjeni numrin e nëpunësve civil të vlerësuar dhe mesataren e vlerësimit për vitin **2024**.

Numri i nëpunësve të vlerësuar:	223
Mesatarja e vlerësimit:	Arrin pritshmërinë

• **Numri i zyrtarëve publik të punësuar në institucion gjatë vitit 2025**

Kategoria e zyrtarëve publik		Nëpunës të shërbimit civil	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës teknik dhe mbështetës	Krijues dhe performues të artit dhe kulturës	Zyrtarë të kabinetit
2025	Gra	10	62	0	0	2
	Burra	4	33	0	0	0
	Gjithsej	14	95	0	0	2

• **Numri i autorizuar i funksionarëve/zyrtarëve publik**

Kategoria e zyrtarëve	Numri i autorizuar
Funksionar publik	50
Nëpunës i shërbimit civil	237
Nëpunës i shërbimit publik	1741
Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	27
Nëpunës teknik dhe mbështetës	224
Zyrtar i kabinetit	6
Gjithsej	2285

- **Numri i nëpunësve të shërbimit civil sipas kategorive dhe gjinisë**

Kategoria e zyrtarëve		Kategoria e ulët drejtuese	Kategoria e specialistëve	Kategoria Profesionale
2025	Gra	14	7	88
	Burra	29	9	79
	Gjithsej	43	16	167

- **Ndryshimi i numrit të nëpunësve të shërbimit civil sipas kategorive gjatë vitit 2025**

Kategoria funksionale	Numri i nëpunësve civil në fillim të vitit 2025	Numri i nëpunësve civil të larguar nga SHC në vitin 2025	Vendet e plotësuara gjatë vitit 2025	Numri i nëpunësve civil në fund të vitit 2025
Kategoria e Ulët Drejtuese	43	2	2	43
Kategoria e Specialistëve	25	9	0	16
Kategoria Profesionale	169	13	11	167
Gjithsej	237	24	13	226

- **Nëpunësit e shërbimit civil sipas nivelit të arsimit**

Kategoria funksionale	Arsimi i mesëm	Bachelor	Master	Doktoratë
Kategoria e Ulët Drejtuese	0	29	14	0
Kategoria e Specialistëve	0	7	9	0
Kategoria Profesionale	21	98	47	1
Gjithsej	21	134	70	1

- **Nëpunësit e shërbimit civil me aftësi të kufizuara**

Kategoria funksionale	Gra	Burra	Gjithsej
Kategoria e Ulët Drejtuese	0	0	0
Kategoria e Specialistëve	0	0	0
Kategoria Profesionale	1	2	3
Gjithsej	1	2	3

- **Përkatësia etnike e nëpunësve të shërbimit civil**

Nacionaliteti	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria e Specialistëve	Kategoria Profesionale	Gjithsej
Shqiptar	42	16	165	223
Serb	0	0	0	0
Boshnjak	0	0	0	0
Turq	0	0	0	0
Goran	0	0	0	0
Rom	0	0	0	0
Ashkali	0	0	0	0
Egjiptian	1	0	2	3
Tjetër	0	0	0	0

- **Ndryshimet eventuale që lidhen me pagën dhe të drejtat në pagë për secilin të punësuar në Komunën e Gjakovës**

Në përputhje me nenin 5 paragrafi 10 i Rregullores (QRK) numër 05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe nenin 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 (pika 3.2.7) të Rregullores numër 01-011/01-16155 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, gjatë vitit 2025 janë bartur në përgjegjësi të njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore ndryshimet eventuale që lidhen me pagën dhe të drejtat në pagë për secilin të punësuar në **arsimin parauniversitar dhe shëndetësinë primare**. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka në përgjegjësi të kësaj natyre edhe administratën e komunës, kulturën, artin dhe zjarrfikësit.

- **Procedurat e rekrutimit për zyrtarët publik**

Kategoria e zyrtarëve	Numri i shpalljeve	Numri i kandidatëve të suksesshëm
Nëpunës i shërbimit civil	16	15
Nëpunës i shërbimit publik	10	160
Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	0	0
Nëpunës teknik dhe mbështetës	0	0
Gjithsej	26	175

- Rekrutimi për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Kategoria funksionale	Numri i shpalljeve	Numri i aplikantëve	Numri i kandidatëve të suksesshëm
Kategoria e Ulët Drejtuese	3	30	3
Kategoria e Specialistëve	0	0	0
Kategoria Profesionale	13	308	12
Gjithsej	16	338	15

- Procedurat e rekrutimit për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Kategoria funksionale	Pozitat e planifikuara në planin e personelit 2025	Pozita të përfunduara me sukses	Procedura të dështuara	Procedura të anuluar	Procedura në proces	Gjithsej procedura të shpallura
Kategoria e Ulët Drejtuese	3	3	0	0	0	3
Kategoria e Specialistëve	6	0	0	0	0	0
Kategoria Profesionale	13	11	2	0	0	13
Gjithsej	16	14	2	0	0	16

- Përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Arsyeja e përfundimit	Kategoria e Ulët Drejtuese	Kategoria e Specialistëve	Kategoria Profesionale
Pensionim	0	1	5
Pensionim i parakohshëm	0	0	0
Dorëheqje	0	0	3
Dënim me vendim të formës së prerë	0	0	0
Vdekje	0	0	1
Paafësi shëndetësore	0	0	0
Lirim si rezultat i vlerësimit të performancës	0	0	0
Arsye tjera (specifiko)	2	8	4
Gjithsej	2	9	13

- **Pushimet e nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2025**

Lloji i pushimit	Numri i kërkesave	Numri i ditëve
Pushim vjetor	1105	6195
Pushim mjekësor	94	493
Pushim pa pagesë	1	334
Gjithsej	1200	7022

Dosjet individuale elektronike për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik/mbështetës janë përpunuar edhe gjatë vitit 2025, duke u ngarkuar dokumentet relevante të secilit nëpunës. Ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar gjatë viteve paraprake.

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar përditësimi i **kontratave të punës** për nëpunësit e shërbimit publik, krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës si dhe nëpunësit teknik/mbështetës duke i harmonizuar të njëjtat me legjislacionin për zyrtarët publik dhe legjislacionin për pagat në sektorin publik. Ndërsa përditësimi **akt emërimeve** për nëpunësit e shërbimit civil është përfunduar.

Në fund, iu informojmë se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka përpiluar Planin e Personelit 2026 numër PP00001943 përmes SIMBNJ dhe i njëjti pas aprovimit nga Kryetari i Komunës është publikuar në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.

Ky raport është punuar në përputhje me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294. I njëjti pas aprovimit nga Kryetari i Komunës do të **publikohet** në ueb faqen e Komunës së Gjakovës, ndërsa deri me 15 shkurt 2026, një kopje e këtij raporti do ti **dorëzohet** Ministrisë së Punëve të Brendshme (*ministrisë përgjegjëse për administratë publike*).

HARTUAR nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore

Kushtrim Brahimaj

MIRATUAR nga Kryetari i Komunës

Ardian Gimi